

VENDIM
Nr.974, datë 2.7.2008

**PËR DHËNIE FONDI KOMUNËS TËRTHORË, PËR REALIZIMIN E PROCEDURAVE
PËR ZHVENDOSJEN E VARREZAVE TË FSHATIT MORINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunës Tërthorë t’i jepet fondi 11 240 000 (njëmbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet mijë) lekë, për realizimin e procedurave, për zhvendosjen e varrezave të fshatit Morinë, si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Kalimash-Morinë, pjesë e autostradës Durrës-Kukës-Morinë.

2. Ky fond të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

3. Procedurat për zhvendosjen e varrezave të fshatit Morinë të përfundojnë brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Përdorimi i fondit të bëhet në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe komuna Tërthorë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi nr.808, datë 21.11.2007 i Këshillit të Ministrave “Për dhënie fondi komunës Tërthorë për realizimin e procedurave për zhvendosjen e varrezave të fshatit Morinë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha